

Gucati beson se ish-krerët
e UÇK-së do të shpallen
të pafajshëm

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

TRUMPI THEMELON BORDIN E PAQES, KOSOVA NËNSHKRUESE

FAQE 4-5



Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump dhe liderët botërorë, përfshirë edhe presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, kanë nënshkruar të enjten në Davos të Zvicrës dokumentin e Bordit të Paqes. Gjatë nënshkrimit të këtij dokumenti presidentja Vjosa Osmani është parë duke komunikuar kokë me kokë me presidentin Trump. Ky i fundit pas nënshkrimit të këtij dokumenti ia ka shtrënguar dorën Osmanit. Presidentja Osmani ka theksuar se kjo marrëveshje historike do t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës për ratifikim, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, për ta marrë miratimin final të përfaqësuesve të popullit

**MBI 1 600 PREMTIME
NGA KRYETARËT E
RINJ TË KOMUNAVE,
INFRASTRUKTURA
KRYEFJALA
E MANDATIT**

F. 3



**PROKURORIA THEMELORE NË
PRIZREN NIS HETIMET PËR
MOSPËRPUTHJET E VOTAVE PAS
RINUMËRIMIT NË ZGJEDHJE**

F. 7



**GUVERNATORI ISMAILI PRET MISIONIN
E RI TË FMN-së PËR FORCIMIN
E SIGURISË KIBERNETIKE**

F. 8

SPORT



**SYLVINHO BESON SE SHOIPËRIA MUND
TË KUALIFIKOHET NË KUPËN E BOTËS**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mod: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi: Ne kemi ushtrinë më të fuqishme në botë

UASHINGTON, 22 JANAR - Pasi renditi arritjet e administratës së tij në skenën globale që nga kthimi i tij në Shtëpinë e Bardhë, presidenti amerikan Donald Trump iu drejtua Venezuelës gjatë samitit në

Davos. “Në fillim të këtij muaji, falë aftësive, fuqisë dhe fuqisë së pakrahasueshme të ushtrisë amerikane, ne kemi ushtrinë më të fuqishme në botë deri më tani, kapëm diktatorin e jashtëligjshëm Nicolas

Maduro”, tha ai. “Jam shumë i lumtur për këtë dhe kemi marrëdhënie të shkëlqyera me udhëheqësit e rinj të Venezuelës. Po bëjmë vend për kompanitë tona gjigante të naftës dhe po shkon shumë

mirë. Tashmë kemi nxjerrë 50 milionë fuçi naftë dhe një pjesë e madhe do të kthehet në Venezuelë”, vazhdoi tutje presidenti amerikan. Sipas tij, Venezuela “do të sjellë më shumë të ardhura me ne në një

periudhë të shkurtër kohore sesa ka sjellë në vite”. “Kompanitë e naftës duan të hyjnë, duan të hyjnë menjëherë, e ne jemi tashmë atje duke vizituar vendet”, përfundoi ai.

SHEFI I NATO-s E KORRIGJON TRUMPIN, THOTË SE SHUMË USHTARË EVROPIANË KANË VDEKUR PËR AMERIKËN

BRUKSEL, 22 JANAR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, i ka bërë një provë realiteti Donald Trump, duke i thënë atij se një ushtar i NATO-s vdiste për çdo dy amerikanë në Afganistan, pasi presidenti i ShBA-së dyshoi në aleancën perëndimore. Duke folur dje në Forumin Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës, Trumpi tha: “Nuk jam i sigurt nëse ata do të ishin aty për ne nëse do t'u bënim thirrje”, ndërsa u përpoq të mblidhte vrull për planin e tij, tani të braktisur, për ta blerë Groenlandën nga Danimarka. “I njoh të gjithë shumë mirë. Nuk jam i sigurt

nëse ata do të ishin atje. E di që ne do të ishim atje për ta. Nuk e di nëse ata do të ishin atje për ne”, tha presidenti amerikan. Megjithatë, pretendimet anashkalojnë faktin se vendet anëtare të NATO-s pësuan qindra vdekje gjatë luftës në Afganistan, e cila u shkaktua pas sulmit të 11 shtatorit në Qendrën Botërore të Tregtisë në Nju-Jork. Vetëm Britania humbi 457 trupa, ndërsa Franca, Gjermania, Italia dhe Danimarka gjithashtu pësuan shumë vdekje. Rutte i tha Trumpit: “Ka një gjë që të dëgjova të thuash dje

dhe sot. Nuk ishit absolutisht të sigurt se evropianët do të vinin në ndihmë të ShBA-së nëse do të sulmoheshit. Më lejoni t'ju them, ata do të vijnë dhe e bënë në Afganistan”. Kundërshtimi erdhi pasi Trumpi e quajti Danimarkën - e cila kishte numrin më të lartë të vdekjeve për frymë midis forcave të koalicionit në Afganistan - ‘mosmirënjohëse’ për mbrojtjen e ShBA-së gjatë Luftës së Dytë Botërore. “Për çdo dy amerikanë që paguan çmimin përfundimtar, kishte një ushtar nga një vend tjetër i NATO-s që nuk u kthye te familja e tij - nga Holanda, nga



Danimarka dhe veçanërisht nga vende të tjera. Pra, mund të jeni të sigurt, absolutisht, nëse ndonjëherë Shtetet e Bashkuara do të ishin nën sulm, aleatët tuaj

do të jenë me ju. Ekziston një garanci absolute. Dua t'ju them këtë sepse më dhemb nëse mendoni se nuk është kështu”, i tha Rutte, Trumpit.

WITKOFF: NUK JEMI NË BISEDIME ME IRANIN

UASHINGTON, 22 JANAR - I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara, Steve Witkoff - duke folur në emër të administratës Trump - tha se ShBA-ja nuk është në bisedime me Iranin tani për tani, megjithëse “kemi pasur kontakt me ta”. Duke folur në një intervistë për CNBC, në margjinat e Forumit Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës, Witkoff tha se “Irani është një marrëveshje që duhet të ndodhë”. I pyetur për hollësi, ai e shmangu përgjigjen, por e përsëriti se ka mundësi për një marrëveshje. Protestat në Iran nisën më 28 dhjetor 2025, në tregjet e kryeqytetit Teheran, nga



tregtarë të zemëruar për kushtet e këqija ekonomike, përfshirë inflacionin e madh dhe rënien e lirë të monedhës. Trazirat u përshkallëzuan me shpejtësi, duke u shndërruar në

demonstrata të gjera kundër autoriteteve për shkak të përkeqësimit të standardeve të jetesës dhe shtypjes të lirive themelore. Tensionet e kahershme mes

Uashingtonit dhe Teheranit pothuajse kanë arritur pikën kulmore gjatë kësaj krize. Presidenti amerikan Donald Trump fillimisht paralajmëroi se Shtetet e Bashkuara ishin “të gatshme dhe të armatosura” dhe të përgatitura për të vepruar nëse forcat iraniane të sigurisë do të vrisnin protestues. Më vonë ai u zotua për “veprime shumë të fuqishme” nëse Irani do të vazhdonte ekzekutimin e protestuesve. Trumpi më pas tha se kishte zgjedhur personalisht të mos urdhëronte sulme ushtarake kundër Iranit, duke ia atribuar këtë vendim anulimit të raportuar nga Teherani të

qindra ekzekutimeve të planifikuara. Në një tjetër intervistë në Davos, Witkoff i tha “Arab News” se Irani duhet të vijë dhe të ulët në tryezën diplomatike. “Kjo duhet të ndodhë [që Irani të negociojë]”, tha ai. “Është e rëndësishme. Nëse shkon Irani, shkon edhe rajoni, ndaj duhet ta sqarojmë këtë”. Witkoff këmbënguli se Lindja e Mesme po lëviz në drejtimin e duhur. “Mendoj se është e jashtëzakonshme ajo që po ndodh. Të gjithë, mendoj, po punojnë së bashku drejt paqes”, tha ai. “Të gjithë janë angazhuar me idetë e presidentit Trump për paqen kufitare dhe kam shumë shpresa”.

Athina përmblytet nga reshjet

ATHINË, 22 JANAR - Një stuhi goditi Greqinë dhe la dy të vdekur, me ekipet e katastrofave që kaluan të enjten duke pastruar mbeturinat. Kostas Lagouvardos, drejtor kërkimesh në Observatorin Kombëtar në Athinë, tha se fenomeni “ekstrem” i motit

kishte sjellë deri në 170 milimetra shi në kryeqytet. Kjo përbënte “rreth 40 për qind të shiut që bie çdo vit në Athinë”, tha ai në kuadër të një prezantimi të të dhënave vjetore të motit për Greqinë. Fronti i stuhisë që lëvizte drejt lindjes nëpër Greqi pa erëra që tejkalonin 100 km/h, duke bërë

që autoritetet t'i mbyllnin shkollat. Departamenti i Zjarrfikësve tha se u është përgjigjur mbi 900 thirrjeve emergjente në lidhje me përmblytjet në të gjithë kryeqytetin. Kryeministri Kyriakos Mitsotakis anuloi një udhëtim të planifikuar për në Forumin

Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës. Ndryshe, përmblytjet vdekjeprurëse në Greqi gjatë reshjeve të dendura të shiut në vitet e fundit i kanë detyruar autoritetet t'i përmirësojnë punimet kundër përmblytjeve për t'i kufizuar dëmet. Ekspertët kanë bërë thirrje të



përsëritura për përmirësime të infrastrukturës, veçanërisht në zonën më të madhe të Athinës.

MBI 1 600 PREMTIME NGA KRYETARËT E RINJ TË KOMUNAVE, INFRASTRUKTURA KRYEFJALA E MANDATIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 JANAR - Instituti GAP në një konferencë për medie të enjten ka shpalosur premtimet që kryetarët e rinj të komunave kanë dhënë për mandatin qeverisës 2025-2029. Gjithsej Instituti GAP ka evidentuar 1 683 premtime të dhëna në 26 komuna, që paraqet 132 premtime më pak sesa në mandatin e kaluar. Sipas GAP-it, rritja më e madhe e numrit të premtimeve është shënuar në Lipjan, Deçan, Fushë-Kosovë, Drenas, Obiliq dhe Podujevë. Në anën tjetër, rënien më të madhe e ka pësuar Prishtina, nga 206 në 115 premtime, e ndjekur nga Kaçaniku, Suhareka, Shtimja, Mitrovica e Jugut, Rahoveci, Hani i Elezit, Malisheva, Klina dhe Istogu. Bekim Salihu, analist politikash në Institutin GAP, tha se fusha me numrin më të madh të premtimeve në këtë mandat ishte infrastruktura, me gjithsej 382 premtime. Pas saj renditet arsimi me 322 premtime, shërbimet publike me 184 premtime dhe shëndetësia me 146 premtime. “Gjithsej, Instituti GAP ka evidentuar 1 683 premtime të dhëna në 26 komuna, që paraqet 132 premtime më pak sesa në mandatin e kaluar. Rritja më e madhe e numrit të premtimeve të dhëna është shënuar në Lipjan, Deçan, Fushë-Kosovë, Drenas,

Obiliq, dhe Podujevë. Nga këto komuna, Lipjani ka shënuar rritjen më të theksuar, nga 61 premtime në mandatin 2021-2025, në 170 premtime në këtë mandat; Deçani nga 20 në 124 premtime; Fushë-Kosova nga 35 në 110 premtime; Drenasi nga 37 në 88; Obiliqi nga 69 në 104; ndërsa Podujeva nga 61 në 88 premtime të dhëna. Në anën tjetër, rënien më të madhe e ka pësuar Prishtina, nga 206 në 115 premtime, e ndjekur nga Kaçaniku, Suhareka, Shtimja, Mitrovica e Jugut, Rahoveci, Hani i Elezit, Malisheva, Klina dhe Istogu”, tha Salihu. Më tutje u theksua se kryetari fitues në Skenderaj, ai në Mamushë dhe dhjetë kryetarët në komunat me shumicë të komunitetit serb, nuk kanë shpalosur asnjë premtim zgjedhor dhe se, nga 26 kryetarë fitues, 17 kanë pasur program të shkruar zgjedhor, kurse nëntë të tjerë kanë prezantuar premtime gjatë aktiviteteteve zgjedhore ose përmes paraqitjeve mediale. “Fusha me numrin më të madh të premtimeve në këtë mandat është infrastruktura, me gjithsej 382 premtime. Pas saj renditet arsimi me 322 premtime, shërbimet publike me 184 premtime dhe shëndetësia me 146 premtime. Në fushat e ekonomisë, bujqësisë, kulturës, sportit dhe çështjeve sociale numri i premtimeve të dhëna është i përafërt me mandatin e



kaluar, përkatësisht rreth ose mbi 100 premtime secila. Më së paku premtime janë dhënë në fushën e urbanizimit (gjithsej 51 premtime) dhe në administratë (50 premtime). Këto të dhëna tregojnë se infrastruktura është rikthyer si prioriteti kryesor në mandatin e ri, duke zëvendësuar shërbimet publike që kishin zënë hapësirën më të madhe në mandatin e kaluar”. “Në zgjedhjet e fundit lokale për kryetarë/e komunash kanë garuar 185 kandidatë, prej të cilëve 165 kanë qenë të propozuar nga subjektet politike, ndërsa pjesa tjetër kanë garuar nga iniciativa qytetare ose si kandidatë të pavarur. Nga 185

kandidatë, vetëm 20 kanë qenë gra dhe prej tyre, vetëm një është zgjedhur kryetare, nga gjithsej 38 kryetarë të zgjedhur. Këtë mandat, Lëvizja Vetëvendosje (VV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do të udhëheqin me nga shtatë komuna secila; Lista Serbe (LS) me dhjetë komuna; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me pesë komuna; ndërsa Nisma Socialdemokrate dhe Partia Turke e Kosovës me nga një komunë. Për dallim nga mandati i kaluar, ku pushteti nga një parti në tjetrën kishte ndryshuar në 12 komuna, përkatësisht në Prishtinë, Shtime, Gjilan,

Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Prizren, Hani i Elezit, Vushtrri, Dragash, Junik, Mamushë dhe Skenderaj, në këtë mandat kjo ka ndodhur në tri komuna: Fushë-Kosovë, Obiliq dhe Mitrovicë e Jugut. Kryetari fitues në Skenderaj, ai në Mamushë dhe dhjetë kryetarët në komunat me shumicë të komunitetit serb nuk kanë shpalosur asnjë premtim zgjedhor. Nga 26 kryetarë fitues, 17 kanë pasur program të shkruar zgjedhor, ndërsa nëntë të tjerë kanë prezantuar premtime gjatë aktiviteteteve zgjedhore ose përmes paraqitjeve mediale”, ka deklaruar Bekim Salihu, analist politikash në Institutin GAP.

GUCATI BESON SE ISH-KRERËT E UÇK-së DO TË SHPALLEN TË PAFAJSHËM



EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 JANAR - Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, beson se ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, do të dalin të pafajshëm, duke theksuar se beson që drejtësia nuk do të jetë selektive e politike. “Besoj se më 16-17 do të jemi në Hagë, do t’i dëgjojmë katër bashkëluftëtarët tanë. Besojmë se do të jemi atje nëse na lejohet. Kemi bërë kërkesë para dy ditësh. Besoj se do të na lejohet të marrim pjesë. Dua të besoj fuqishëm se ata do të dalin të pafajshëm”, ka thënë Gucati pasi bëri homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz në 28-vjetorin e sulmit të dytë ndaj familjes së komandantit legjendar, Adem Jashari. Gucati ka bërë me dije se do të marrin pjesë në protestën e 17 shkurtit që është thirrur nga platforma “Liria ka Emër”, e ku do të bëhet thirrje për drejtësi ndaj çlirimtarëve.

Me moton “Drejtësi, jo politikë”, do të protestohet më 17 shkurt në orën 14:00 në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, që qëllim ka vetëm mbrojtjen e çlirimtarëve të cilët po mbahen në Hagë. Protesta do të organizohet nga platforma “Liria ka Emër”, ku gjatë një konference për medie, Eliza Hoxha e Ismail Tasholli, kanë theksuar se data 17 shkurt nuk është zgjedhur rastësisht, por se ajo përkon me Ditën e Pavarësisë së Kosovës dhe me momentin historik të shpalljes së saj, duke e bërë këtë protestë një akt simbolik dhe qytetar në mbrojtje të parimit të drejtësisë. Platforma “Liria ka Emër” ka vlerësuar se procesi gjyqësor në Hagë, i cili ka hyrë në fazën përmbyllëse pas më shumë se pesë vjetësh, ka krijuar shqetësime serioze në opinionin publik. Zvarritja e procedurave, kompleksiteti i tyre, informacionet kontradiktore, si dhe perceptimi i ndikimit politik, kanë cenuar besimin qytetar se drejtësia po trajtohet si një proces thjesht juridik.



TRUMPI THEMELON BORDIN E PAQES, KOSOVA NËNSHKRUESE

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump dhe liderët botërorë, përfshirë edhe presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, kanë nënshkruar të enjten në Davos të Zvicrës dokumentin e Bordit të Paqes. Gjatë nënshkrimit të këtij dokumenti presidentja Vjosa Osmani është parë duke komunikuar kokë me kokë me presidentin Trump. Ky i fundit pas nënshkrimit të këtij dokumenti ia ka shtrënguar dorën Osmanit. Presidentja Osmani ka theksuar se kjo marrëveshje historike do t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës për ratifikim, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, për ta marrë miratimin final të përfaqësuesve të popullit

Këshillit të Sigurimit të OKB-së, përveç ShBA-së, nuk ishin të pranishëm, ndonëse të gjithë ishin ftuar që të bashkohen.

Gjatë nënshkrimit të këtij dokumenti presidentja Vjosa Osmani është parë duke komunikuar kokë me kokë me presidentin Trump, ndërsa ky i fundit pas nënshkrimit të këtij dokumenti ia ka shtrënguar dorën Osmanit.

Për këtë ngjarje ka shkruar Osmani në rrjetet sociale. "Sot, në Davos, në emër të Republikës së Kosovës, kam nënshkruar Kartën e Bordit të Paqes si anëtare themeluese, e barabartë dhe me të drejta të plota, krah për krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të paqes e që udhëhiqen nga aleati ynë strategjik, fuqizon sovranitetin tonë, pozicionin

tonë ndërkombëtar, si dhe është në interesin më të lartë të Republikës së Kosovës. Prandaj, kjo marrëveshje historike do t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës për ratifikim, në përputhje me kushtetutën e Kosovës, për të marrë miratimin final të përfaqësuesve të popullit. Faleminderit presidentit Trump për leadershipin e tij dhe për ftesën që ta përfaqësoj Republikën e Kosovës në këtë moment historik.

Kosova do të jetë në shërbim të paqes, sot e përherë!", ka shkruar Osmani.

Osmani tha të mërkurën se "me krenari të madhe e kam pranuar këtë ftesë personale të presidentit Trump".

Ajo shtoi se Kosova, sado e vogël, "mund të japë kontribut të madh në realizimin e këtyre synimeve. Jam duke punuar afër me Shtëpinë e Bardhë që kontributi ynë të jetë konkret dhe domethënës".

Kreu i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka mirëpritur përfshirjen e Kosovës në Bordin e Paqes për Gazën, duke u shprehur se çdo hap i përbashkët me ShBA-në e vendos Kosovën në anën e paqes. Sipas tij, përfshirja e Kosovës në këtë nismë ndërkombëtare të udhëhequr nga presidenti amerikan, Donald Trump, "është një moment që tejkalon secilin lajm ditor". "Në një botë gjithnjë e më të fragile, çdo hap i përbashkët me ShBA-të është hap që forcon sigurinë tonë kombëtare, thellon aleancat tona strategjike dhe e

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

DAVOS, 22 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka lansuar Bordin e Paqes, një trup i ri për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare, duke përsëritur bindjen e tij se një marrëveshje e paqes për t'i dhënë fund pushtimit rus të Ukrainës "do të arrihet shumë shpejt".

Ky trup i ri fillimisht ishte i përqendruar në zbatimin e marrëveshjes për përfundimin e luftës Izrael - Gazë, ashtu siç është miratuar nëntorin e vitit të kaluar me Rezolutën 2803 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, por udhëheqësi amerikan tha se ai do të punojë që të sigurojë paqe në mbarë botën. "Ne do të punojmë me shumë të tjerë, përfshirë OKB-në", tha Trumpi gjatë ceremonisë së nënshkrimit në Davos të Zvicrës më 22 janar, duke iu referuar me gjasë shqetësimeve se Bordi do të synojë të zëvendësojë OKB-në,

institucion që Trumpi e ka kritikuar shpesh.

Në ceremoni morën pjesë udhëheqës nga Kosova, Bahrejni, Argjentina, Armenia, Azerbajxhani, Belgjika, Bullgaria, Egjipti, Hungaria, Indonezia, Jordania, Kazakistani, Mongolia, Pakistani, Paraguai, Katari,

Arabia Saudite, Turqia, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Uzbekistani. Që të gjitha këto shtete janë pajtuar që t'i bashkohen Bordit të Paqes.

Shtete të tjera kanë sinjalizuar gatishmëri për t'u bashkuar, përfshirë Bjellorusinë, Izraelin dhe Vietnamin. Asnjë nga pesë anëtarët e përhershme të



PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN NIS HETIMET PËR MOSPËRPUTHJET E VOTAVE PAS RINUMËRIMIT NË ZGJEDHJE

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRIZREN, 22 JANAR - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, ka pritur në takim Koordinatoren Nacionale për Zgjedhje, Laura Pula dhe menaxherin e projektit strategjik “Mbrotja e votës”, Besim Kusari. Takimi është zhvilluar në ambientet e Prokurorisë së Prizrenit dhe temë e diskutimeve të këtij takimi ishte zhvillimi i hetimeve paraprake lidhur me mospërputhjen e votave gjatë numërimit brenda subjekteve politike për deputetë të Republikës së Kosovës në regionin e komunës së Prizrenit. Kryeprokurori i Prizrenit



informoi se pas evidentimit të mospërputhjeve të votave gjatë numërimit brenda subjekteve politike për deputetë, në rajonin e komunës së Prizrenit, ku ka përfunduar procesi i rinumërimit të votave, ka filluar grumbullimi i informatave të nevojshme, sigurimi i provave relevante, që të vërtetohet kryerja e ndonjë

vepre penale që ndërlidhet me procesin zgjedhor. Gjatë këtij takimi u diskutua për angazhimin e Prokurorit të Shtetit lidhur me mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës si dhe vazhdimin e procesit të hetimit në drejtim të mbledhjes së provave dhe sigurimit të dëshmive të nevojshme.

Në QNR rinumërohen 1 029 nga 2 557 vendvotime, procesi përmbyllet plotësisht në 9 komuna

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është duke vazhduar numërimi i fletëvotimeve sipas listës së vendvotimeve për të cilat KQZ ka marrë vendim që të rinumërohen. Nga fillimi i këtij procesi (e martë, 13 janar 2026, ora 18:00) dhe deri më tani (e enjte, 22 janar 2026, ora 10:00) janë rinumëruar 1 029 nga 2 557 vendvotime. Sipas këtyre të dhënave, deri më tani rinumërimi është përmbyllur plotësisht në 9 komuna. Në kohën kur dukej se Kosova po shkonte drejt formimit të institucioneve të reja pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, procesi zgjedhor u kthye disa

hapa prapa. Zbulimi i mospërputhjeve serioze në votat e kandidatëve për deputetë e detyroi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të marrë vendim për rinumërim të plotë të të gjitha votave në vendvotimet e rregullta. Vendimi i marrë më 19 janar pasoi rinumërimin e pjesshëm nga java e kaluar, gjatë të cilit u evidentuan shkelje dhe dallime të theksuara, si dhe thirrjet e vazhdueshme të partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile për një rinumërim tërësor të votave. Për vëzhguesit e proceseve zgjedhore dhe zhvillimeve politike në Kosovë, ky vendim ishte i domosdoshëm për mbrojtjen e integritetit të votës, njëkohësisht hap rrezikun e vonesave të gjata procedurale dhe të një krize të mundshme institucionale.

Policia e Kosovës dhe KFOR-i forcojnë gatishmërinë operacionale

PRISHTINË, 22 JANAR - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me ushtarë nga Batalioni Manovrues i Komandës Rajonale - Lindje të misionit të udhëhequr nga KFOR/NATO, ka realizuar një ushtrim të përbashkët të quajtur “Incident Command Walkthrough”.

Qëllimi ishte që përmes këtij aktiviteti të bëhet ushtrimi i procedurave standarde të operimit, mekanizmave të komandimit, kontrollit si dhe metodave të koordinuara të reagimit, duke siguruar një nivel të lartë të gatishmërisë operacionale dhe një përgjigje

efektive ndaj çdo sfide të mundshme të sigurisë. Angazhimet e tilla të përbashkëta pasqyrojnë profesionalizmin, koordinimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Policisë së Kosovës dhe KFOR-it, në funksion të përmbylljes

së misionit për garantimin e një mjedisi të sigurt dhe stabil për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Policia e Kosovës vlerëson angazhimin e të gjithë mbështetësve të saj të cilët kontribuojnë në avancimin sa më profesional të PK-së.



vendos Kosovën aty ku i takon; në anën e paqes dhe aleancave të drejta”, shkroi ai në Facebook. Abdixhiku tha se partia e tij e mbështet këtë hap të Kosovës drejt një kapitulli të ri. “Sepse sukseset e Kosovës janë arritje kombëtare para së cilave e me të cilat mburremi të gjithë”, u shpreh ai.

Rubio e lavdëron Bordin e Paqes

Pas nënshkrimit nga të gjitha vendet anëtare, fjalën e ka marrë sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio. Ai e lavdëroi Bordin e Paqes dhe ia atribuoi Trumpit meritat për themelimin

e tij. “Ai [Trump] nuk kufizohet nga disa nga gjërat që kanë ndodhur në të kaluarën dhe është i gatshëm të flasë ose të angazhohet me këdo në interes të paqes”, tha Rubio. Ai theksoi se detyra e këtij bordi, “së pari dhe kryesisht”, është “të garantojë se kjo marrëveshje pajeje në Gazë do të bëhet e

qëndrueshme”. Pastaj Rubio tha se mund të shikojë edhe drejt vendeve të tjera. Meqenëse hollësitë e veprimtarisë së bordit janë ende të paqarta, Rubio e përshkroi atë si punë në zhvillim e sipër. Një fjalim të shkurtër pas nënshkrimit e ka mbajtur edhe

diplomati bullgar dhe ish-ministri i Jashtëm, Nikolay Mladenov, i cili do ta udhëheqë administratën kalimtare në Rripin e Gazës. Ai do ta mbajë pozitën e përfaqësuesit të lartë për Gazën. Në fjalën e tij, Mladenov u ka bërë thirrje edhe vendeve të tjera që t'i bashkohen Bordit të Paqes.

Inspektorët komunalë në Mitrovicë, aksion për lirimin e trotuareve

MITROVICË, 22 JANAR - Drejtori i Inspeksionit në Mitrovicë, Mujë Igrishta, së bashku me inspektorët komunalë dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë zhvilluar aksione për lirimin e

hapësirave publike, përkatësisht trotuareve të zëna nga biznese afariste pa leje. Vlen të potencohet se bizneset kanë treguar bashkëpunim gjatë këtyre

veprimeve, ndërsa Inspeksioni ka njoftuar se aksionet do të vazhdojnë në të gjitha rrugët e qytetit deri në lirimin e plotë të të gjitha trotuareve dhe hapësirave publike të shfrytëzuara pa

autorizim. “Qëllimi i këtyre aksioneve është garantimi i lëvizjes së lirë dhe të sigurt për këmbësorët dhe respektimi i rendit publik”, është shprehur drejtori Igrishta.



VEPRIMTARI SALI BISLIMI VIZITON JAKUP KRASNIQIN NË HAGË, NDAN ÇASTE NGA BISEDA

HAGË, 22 JANAR - Veprimtari Sali Bislimi ka zhvilluar një vizitë disaorëshe në Qendrën e Paraburgimit në Hagë, ku është takuar me ish-kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, i cili po mbahet në paraburgim nga Dhomat e Specializuara. Sipas Bislimit, takimi me Jakup Krasniqin ka zgjatur rreth tri orë e gjysmë dhe është zhvilluar në një atmosferë emocionale të forta, krenarie dhe dhimbjeje për vitet e humbura, të cilat ai i cilëson si padrejtësi. Ai e përshkruan Krasniqin si një personalitet i

qëndrueshëm, i arsyeshëm dhe i ekuilibruar në vlerësimet e tij për zhvillimet aktuale politike.

POSTIMI I BISLIMIT:

Vizitë te gjigantët e historisë së Kosovës

Do të fiton drejtësia jo tirania. 3 orë e gjysmë përballë bacit Jakup Krasniqi në burgun famëkeq të Hagës. Baci Jakup një kalibër i papërsëritshëm patriotik i vendin tonë.



Presidenti Thaçi në sanksione akoma për vizita. Me një histori përmbledhëse, në të gjitha sfidat e jetës së tij. Bisedën e patëm me plotë emocion, krenari, dhimbje, me të gjitha këto vite të humbura për një padrejtësi. Shtetin të cilin e krijuam nuk na respektoj, është një dhimbje, si një herë nuk ndodhi që dikush nga ta t'i vizitojë familjet tona. I ekuilibruar dhe i arsyeshëm mbi politiken aktuale, një Dardan autentik i cili edhe falë gabimet e atyre që nuk dinë dhe nuk duan t'i nderojnë etërit e shtetit të tyre. Gjithmonë jam kanë në burgje hetimore, ato burgjet e Serbisë ma kanë marrë jetën në moshën me të mirë, por e kam ditë pse jam në burg, doja të çlirojmë një pjesë të Shqipërisë, e arritëm me gjithë çmimin e lartë që paguam, por këtë të Hagës nuk e meritua. Baci Jakup, kjo gjykatë politike do të përfundon shpejt, ata që dëshmuar ishin të përpunuar nga UDB serbe, shumica ishin për të fituar azil dhe leje qëndrimi në Europë. Baci Jakup, ta kam pru vetëm një simbol të Kishës së Laçit Shna Ndou (Saint Anthony) aty



ku luten dhe ndihmohen shqiptarët, unë aty jam lutë për ty që të bëhesh 120 vjet, edhe për të gjithë në bazilikën Shen Pjetër në Vatikan. Baci Jakup kishte marrë me vete një qese me mandarina, molla, çokollatë të zezë, ujë dhe coca zero. I hëngrëm bashkë, një burrë i urtë me kaq shpirt të madh, kështu ishin patriotët e Kosovës pa të cilët nuk kishte ardhur liria. Takova edhe Calin aty brenda

kishte familjen e vet në vizite, u përshëndetem dhe ndamë momente shprese, duke uruar që kësaj pranvere të gjithë të na kthehen në Kosovë. Lotët e familjes së Calit kur u përshëndetem mu gravuan në zemër. Ah Kosovë. Djali i tij, Skifteri na bëri një foto kujtimi. Unë nuk po kthehem po vazhdoj misionin. Pa drejtësi nuk ka paqe në atdheun tim!

NË KOSOVË KONFISKOHEN MBI 80 KILOGRAMË DROGË DHE ARRESTOHEN TRE PERSONA



PRISHTINË, 22 JANAR - Policia e Kosovës tha se ka konfirmuar mbi 80 kilogramë drogë gjatë një operacioni të zhvilluar të mërkurën dhe të enjten, kur u arrestuan edhe tre të dyshuar. “Me urdhër të prokurorit të shtetit ndaj tre të dyshuarve është lëshuar aktvendimi për ndalimin prej 48 orëve, ndërkaq prokurori i shtetit me kohë do të

ndërmarr të gjitha veprimet e më tutjeshme hetimore”, u tha në njoftim. Sipas njoftimit, në orën 23:00 të së mërkurës afër pikëkalimit kufitar në Merdar - që lidh Kosovën dhe Serbinë - është ndaluar i dyshuari H. S. që po drejtonte një kamion. Gjatë kontrollit të mjetit autoritetet thanë se gjetën 68

paketime të mbushura me substancë të dyshuar narkotike të llojit marijuanë, me peshë prej 76 kilogramë e 800 gramësh. Autoritetet thanë se hetimet për këtë rast, të koduar “Bregdeti”, kanë nisur disa muaj më parë, duke shtuar se gjatë kontrollit në shtëpinë e H. S. janë gjetur edhe armë zjarri, fishekë dhe para të gatshme.

Ndërkaq, të enjten ka vazhduar ky operacion, ku janë bastisur shtëpitë e dy të dyshuarve të tjerë në Godishnjak të Podujevës, ku u gjetën edhe katër paketime me substancë që dyshohet të jetë marijuanë me peshë prej 4 kilogramësh e 454 gramësh. Policia tha se në bastisjen e së enjtes u gjet edhe një armë zjarri me gaz.

Rama: Bashkëpunimi me Francën mbetet partneritet i rëndësishëm për kryeqytetin dhe Kosovën

PRISHTINË, 22 JANAR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Oliver Guerot, me të cilin ka diskutuar për forcimin e mëtejshëm të

bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët, përfshirë arsimin, kulturën dhe zhvillimin e qytetit. Rama ka thënë se partneritetet e qëndrueshme ndërtojnë ura bashkëpunimi

dhe hapin mundësi të reja për qytetarët e kryeqytetit. “Bashkëpunimi me Francën mbetet një partneritet i rëndësishëm për kryeqytetin dhe Kosovën”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



LIGJVËNËSIT AMERIKANË I KËRKOJNË DASH-it T’I SHQYRTOJË PRETENDIMET PËR DISKRIMINIM NDAJ SHQIPTARËVE NË SERBI



PRISHTINË, 22 JANAR - Anëtarët e Komitetit për Punë të Jashtme të Kongresit amerikan kanë votuar të mërkurën vonë për ta çuar përpara një projektligj, i cili do t’i kërkonte Sekretarit amerikan të Shtetit ta përgatisë një raport gjithëpërfshirës lidhur me trajtimin e pakicave etnike në Serbi, posaçërisht të shqiptarëve etnikë në Luginën e Preshevës.

Me 43 vota për, tri kundër dhe asnjë abstenim kaloi ky projektligj i sponsorizuar nga kongresisti republikani Keith Self.

Pasi ta kalojë shqyrtimin e plotë, ky projektligj do të raportohet nga Komiteti për Punë të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve dhe do t’i dërgohet për votim gjithë Dhomës së Përfaqësuesve. Më pas ai duhet të miratohet edhe nga Senati dhe të nënshkruhet nga presidenti amerikan Donald Trump.

Në Serbi jetojnë më shumë se 60 000 shqiptarë, të cilët përbëjnë pakicën e katërt më të madhe atje, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 2022.

Në raportet ndërkombëtare, Lugina e Preshevës - term që përdoret për Preshevën,

Medvegjën dhe Bujanocin, komuna të banuara me shumicë shqiptare në jug të Serbisë - konsiderohet tërësisht e izoluar dhe thuhet se merr vëmendje vetëm në kohë zgjedhjesh.

Projektligji kërkon të vlerësohen çështje me rëndësi, përfshirë pasivizimin e adresave të shqiptarëve, kufizimet në përdorimin e gjuhës shqipe në institucionet publike, diskriminimin në arsim, përfshirë mosnjohjen e diplomave të Kosovës dhe mungesën e teksteve shkollore në gjuhën shqipe.

Çështja e diplomave është rregulluar me disa marrëveshje të arritura në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel dhe me një marrëveshje mes vendeve të Ballkanit Perëndimor në samitin në kuadër të Procesit të Berlinit. Kosova i ka respektuar këto marrëveshje.

Politikanë shqiptarë në Serbi e përshëndetën vendimin e Komitetit për avancimin e projektligjit.

Shaip Kamberi, përfaqësuesi i vetëm i shqiptarëve në Kuvendin e Serbisë, shkroi në “Facebook” se “një betejë e gjatë

dhe e drejtë, sot e kurorëzuar me sukses. Shtetet e Bashkuara po kërkojnë përgjegjësi ligjore dhe politike nga Beogradi për diskriminimin sistematik të shqiptarëve në Luginën e Preshevës”.

Kryetarja e Preshevës, Ardita Sinani, e përshkroi vendimin e Komitetit si “mesazh i qartë për Beogradin”. “Kjo është ditë e rëndësishme për shqiptarët e Luginës. Dhe sinjal se padrejtësia nuk është e përjetshme. Një betejë e gjatë. Me durim, këmbëngulje dhe besim”, shkroi ajo në “Facebook”.

Për çfarë ankohen shqiptarët?

Shqiptarët e Luginës shpesh ankohen për praktika diskriminuese nga shteti serb, teksa zyrtarët në Qeverinë e Kosovës u kanë bërë jehonë këtyre akuzave.

Rasti i pasivizimit të adresave është një çështje për të cilën ata janë ankuar vazhdimisht dhe kanë dalë në rrugë për të protestuar.

Pasivizimi nënkupton fshirjen e qytetarëve prej adresave ku

kanë qenë të regjistruar. Ky hap rezultoi me humbjen e shtetësisë serbe, rrjedhimisht të të gjitha të drejtave civile - përfshirë të drejtën për të votuar, për të pasur pronë, për të pasur sigurim shëndetësor e pension dhe për t’u punësuar. Kjo çështje është përmendur edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në Serbi për vitin 2023.

Shqiptarët në këtë pjesë të Serbisë ankohen edhe për mungesë të teksteve shkollore në gjuhën shqipe, për çfarë Qeveria e Kosovës shpesh u ka ndarë të holla.

Kosova i ka ndihmuar ata edhe në fusha të tjera, si bujqësi, por është ankuar se Serbia po i bllokoi pagesat.

Ndërkohë vendimi i qeverisë serbe për ta kthyer shërbimin e detyrueshëm ushtarak po ashtu ka ngjallur frikë në mesin e shqiptarëve atje, të cilët thonë se kanë përvoja të hidhura nga e kaluara.

Në fund të vitit të kaluar, deputeti Kamberi bëri kërkesë për themelimin e një komisioni të posaçëm parlamentar për t’i hetuar rastet e vdekjes së ushtarëve shqiptarë në ushtrinë

e atëhershme jugosllave gjatë viteve ’80. Në kërkesë, Kamberi thekson se në Luginën e Preshevës ekziston shqetësim për thirrjen e mundshme të rinjve shqiptarë për ta kryer shërbimin ushtarak, “pasi e kaluara dhe pasojat e saj ende ndikojnë në vetëdijen kolektive të shqiptarëve”.

Në raportin e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, të vitit 2021, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci përshkruhen si pengje të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Përfaqësuesit e Luginës dhe shteti serb kanë arritur tri marrëveshje - më 2001, 2007 dhe 2013 - që parashohin mbrojtjen e të drejtave dhe integrimin e pakicës shqiptare, por nuk janë bërë lëvizje në zbatimin e tyre.

Integrimi i shqiptarëve në institucione është pjesë e obligimeve të Serbisë në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Megjithatë, mungesa e investimeve dhe barrierat e vazhdueshme besohet se kanë ndikuar në largimin e rreth 20 000 shqiptarëve prej këtij rajoni, kryesisht drejt shtetit të Kosovës.

ShBA dhe Kosova forcojnë partneritetin ekonomik përmes Odës Ekonomike Amerikane

PRISHTINË, 22 JANAR - E ngarkuara me punë në Ambasadën e ShBA-së në Prishtinë, Anu Prattipati, ka prituri në takim drejtorin ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (AmCham/OEAK), Arian Zeka, dhe presidentin e Bordit të OEAK-së, Lorik

Fejzullahu. Siç njofton Ambasada Amerikane, temë diskutimi ka qenë thellimi i bashkëpunimit ekonomik ShBA - Kosovë. “Si një urë kyçe për kompanitë amerikane, AmCham ndihmon në promovimin e një klime mikpritëse për biznesin dhe lidh bizneset

përmes delegacioneve drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës - duke mbështetur investimet dypalëshe dhe rritjen e përbashkët”, ka njoftuar Ambasada në një postim në “Facebook”, të cilin e përmbylli me fjalinë “Partneri i preferuar i ShBA-së”.



GUVERNATORI ISMAILI PRET MISIIONIN E RI TË FMN-së PËR FORCIMIN E SIGURISË KIBERNETIKE

PRISHTINË, 22 JANAR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatorët Dardan Fusha dhe Milot Cakaj, së bashku me bashkëpunëtorë, priti delegacionin e ekspertëve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), i udhëhequr nga Gabriel Andrade me pjesëmarrjen e Majid Malaika, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet BQK-së dhe FMN-së. Misioni i FMN-së udhëhiqet nga Gabriel Andrade, drejtor i Departamentit për Pajtueshmërisë dhe Menaxhimin të Rrezikut në Bankën Qendrore të Portugalisë (Banco de Portugal), si dhe nga Majid Malaika nga Departamenti i TI-së dhe Këshillimit Digjital në FMN. Ky mision ka për qëllim mbështetjen e BQK-së në zbatimin e një projekti të ri që fokusohet në menaxhimin e

rrezikut, sigurinë kibernetike dhe përdorimin e brendshëm të inteligjencës artificiale (IA). Guvernatori Ismaili informoi delegacionin e FMN-së mbi punën në vazhdim dhe prioritetet strategjike të BQK-së në fushat e menaxhimit të rrezikut, sigurisë kibernetike dhe përdorimit të brendshëm të inteligjencës artificiale. Ky mision realizohet si përgjigje ndaj kërkesës zyrtare të BQK-së për Asistencë Teknike (AT) nga FMN-ja, e cila u konfirmua nga FMN në qershor 2025 dhe është në përputhje me Planin Strategjik të BQK-së. Në fillim të takimit guvernatori Ismaili theksoi përparimin e BQK-së në zbatimin e rekomandimeve nga misionet e mëparshme të Asistencës Teknike të FMN-së si dhe projektet e përbashkëta në vazhdim në fusha të ndryshme, përfshirë edhe misionin e fundit për menaxhimin e rrezikut të udhëhequr nga Andrade. Diskutimet u përqendruan në



sfidat aktuale që ndikojnë në menaxhimin e rrezikut, veçanërisht në kontekstin e reziqeve të shtuara gjeopolitike, reziqeve kibernetike me fokus të veçantë në rreziqet nga palët e treta, si dhe reziqeve në zhvillim që lidhen me inteligjencën artificiale. Gjatë kësaj faze të vizitës në

ambientet e BQK-së, ekipi i misionit të FMN-së do t'i paraqesë gjetjet e shqyrtimit paraprak dhe do të zhvillojë diskutime të thelluara me Departamentet e Menaxhimit të Rrezikut, Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike të BQK-së për t'i përcaktuar hapat e ardhshëm.

Rekomandimet që do të dalin nga ky mision do të shërbejnë si udhërrëfyes për planin e veprimit të BQK-së me qëllim forcimin e mëtejshëm të qëndrueshmërisë institucionale, kapaciteteve profesionale dhe standardeve në këto fusha kyçe, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

RAPORTIMI FINANCIAR NË KOMUNA NË FOKUS TË PUNËTORISË SË PËRBASHKËT ZKA-DEMOS

EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 JANAR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në bashkëpunim me projektin DEMOS, të mërkurën organizoi punëtorinë “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar në nivelin komunal”, me pjesëmarrjen e zyrtarëve kryesorë financiarë dhe zyrtarëve të tjerë nga komunat e Kosovës. Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, në fjalën e saj tha se rezultatet e auditimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2024 tregojnë se raportimi financiar në nivelin lokal vazhdon të përballet me sfida serioze. “Nga 38 komuna, 31 prej tyre kanë marrë opinion të modifikuar. Ky fakt flet qartë se ende ekziston një hendek i konsiderueshëm ndërmjet kërkesave të standardeve të raportimit financiar dhe praktikës aktuale në shumicën e



komunave”, u shpreh Spanca. Auditorja e përgjithshme kërkoi vëmendjen e zyrtarëve komunalë për çështjet që kanë ndikuar në përcaktimin e opinionit të auditimit, e që kryesisht lidhen me klasifikimin jo të saktë të shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe mangësitë në shpallorsjen dhe paraqitjen e

detyrimeve të papaguara dhe atyre kontingjente. Ajo tha se kjo punëtori duhet të shërbejë si thirrje për veprim dhe se zbatimi i rekomandimeve të auditimit nuk duhet të shihet vetëm si obligim formal, por si një mjet praktik për përmirësimin e qeverisjes financiare në komuna. Nga ana e tij, menaxheri i projektit DEMOS, Ertan

Munoglu, e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me ZKA-në, por edhe me Thesarin dhe Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, duke theksuar se projekti do të vazhdojë t'i mbështesë komunat në adresimin e çështjeve që ndikojnë në opinion dhe uljen e gabimeve në raportim. Gjatë punëtorisë drejtorët e

auditimit, Blerim Kabashi dhe Lavdim Maxhuni, paraqitën çështjet kryesore që kanë ndikuar në opinionin e auditimit në nivelin lokal si dhe çështjet që lidhen me pagesat për vendime gjyqësore dhe shpjegimet për shpallorsje. Gjatë diskutimeve të hapura, zyrtarët komunalë ngritën shqetësime lidhur me vështirësitë në trajtimin e çështjeve që kanë ndikuar në opinionin e auditimit, përfshirë pagesat nga vendimet gjyqësore dhe përmbarimore, veçanërisht ato që lidhen me kontratën kolektive dhe barrën financiare që paraqesin për komunat. Punëtorja shërbeu si platformë për dialog profesional dhe shkëmbim përvojash, duke riafirmuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet ZKA-së, DEMOS-it dhe komunave për rritjen e transparencës, përmirësimin e raportimit financiar dhe forcimin e llogaridhënies në nivelin lokal.

Sekuestron 237 mijë ambalazhe të paligjshme për cigare

Prishtinë, 22 janar - Dogana e Kosovës, përmes Zyrës Doganore në Prishtinë, në kuadër të aktiviteteve të rregullta të kontrollit doganor dhe menaxhimit të riskut, ka realizuar një kontroll të hollësishëm doganor ndaj një dërgese të ardhur nga Turqia. Gjatë këtij kontrolli zyrtarët doganorë kanë zbuluar dhe

sekuestruar gjithsej 237 000 copë/pako për ambalazhim të 20 cigareve të cilat mbanin mbishkrimin “DRINA”. Malli nuk ishte i deklaruar në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi dhe dyshohet se kishte për qëllim përdorimin për prodhim ose paketim të produkteve të duhanit në kundërshtim me

dispozitat ligjore, me ç'rast efekti në parandalim nga humbjet potenciale fiskale është rreth 340 000 euro. Janë ndërmarrë menjëherë veprimet procedurale përkatëse, përfshirë sekuestrimin e mallit dhe inicimin e procedurave administrative kundërvajtëse dhe hetimore në

bashkëpunim me institucionet kompetente. Dogana e Kosovës mbetet e përkushtuar në parandalimin e tregtisë së paligjshme, mbrojtjen e tregut dhe shëndetit publik si dhe në garantimin e konkurrencës së ndershme për bizneset që veprojnë në përputhje me ligjin.



GROENLANDA KURRË NUK KA QENË AMERIKANE, HISTORIA REALE DHE MITET E DONALD TRUMP



Deklaratat e Donald Trump në Davos, sipas të cilave Groenlanda ka qenë dikur territor amerikan, kanë ringjallur një debat të vjetër, por të mbushur me keqinterpretime historike. Në realitet, sovraniteti i Danimarkës mbi ishullin më të madh në botë nuk është vënë kurrë seriozisht në diskutim nga Shtetet e Bashkuara, pavarësisht pranisë së tyre ushtarake gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Trump pretendoi se, pasi Danimarka u mposht nga Gjermania naziste brenda pak orësh, SHBA-të u detyruan të dërgonin trupa në Groenlandë dhe se pas përfundimit të luftës ia kthyen ishullin Kopenhagenit, një veprim që ai e quajti “budallallëk”. Por faktet historike tregojnë një histori tjetër.

Në prill të vitit 1941, kur SHBA-të ishin ende zyrtarisht neutrale, Uashingtoni nënshkroi një “marrëveshje mbrojtjeje” për

Groenlandën, me qëllim parandalimin e një pushtimi të mundshëm nazist. Marrëveshja u firmos nga ambasadori danez në SHBA, në emër të Mbretit, pasi Danimarka ishte nën okupim gjerman. Në asnjë moment kjo nuk përbënte transferim sovraniteti.

Interesi amerikan ishte kryesisht strategjik dhe ekonomik. Groenlanda strehonte të vetmin burim në botë të kriolitit, një mineral jetik për prodhimin e aluminit, të nevojshëm për motorët dhe avionët luftarakë. Trupat e para amerikane u vendosën përreth minierës së Ivittuut-it dhe deri në vitin 1945 u ndërtuan rreth 15 instalime ushtarake.

Kushtet ekstreme klimatike, i ftohti polar dhe erërat e pamëshirshme, e bënë të pamundur shndërrimin e Groenlandës në bazë ajrore për shoqërimin e anijeve drejt

Britanisë së Madhe. Megjithatë, ishulli u përdor si pikë kyçe tranziti për transferimin e mijëra bombarduesve dhe avionëve luftarakë përtej Atlantikut.

Nga ana tjetër, forcat naziste ngritën stacione të vogla radioje dhe meteorologjike për të ndihmuar operacionet e nëndetëseve. Disa prej tyre transmetonin edhe sinjale mashtruese për të çorientuar pilotët amerikanë, duke shkaktuar raste dramatike, përfshirë uljen e detyruar të një skuadriljeje në akullnajë.

Neutralizimi i këtyre postacioneve iu besua “Greenland Patrol”, një njësi e Rojës Bregdetare amerikane, por përplasjet e drejtpërdrejta u zhvilluan kryesisht nga një repart danez, me vullnetarë groenlandezë dhe norvegjezë, që lëviznin me slita të tërhequra nga qenët. Ata përballuan marshime ekstreme, deri në 500 kilometra,


në temperatura nën -20 gradë Celsius, një provë e jashtëzakonshme fizike dhe psikologjike.

Pas luftës, rëndësia e Groenlandës u rrit edhe më shumë me nisjen e Luftës së Ftohtë. Në vitin 1946, SHBA-të tentuan ta blinin ishullin nga Danimarka për 100 milionë dollarë, por oferta u refuzua. Megjithatë, amerikanët nuk u larguan. Pas anëtarësimit të Danimarkës në NATO, në vitin 1951 u nënshkrua një traktat që lejonte SHBA-të të mbanin dhe të ndërtonin baza ushtarake për nevojat e Aleancës Atlantike.

Kështu lindi baza ajrore e Thule-s, ende sot një nga instalimet më të rëndësishme ushtarake amerikane në Arktik. Madje, gjatë kulmit të përplasjes bërthamore me Bashkimin Sovjetik, u ndërtua edhe Camp Century, një bazë futuriste 30 metra nën akull, e furnizuar me reaktor

bërthamor, pjesë e projektit sekret “Iceworm”, që synonte vendosjen e raketave ndërkontinentale nën akull. Projekti dështoi kur u kuptua se nxehtësia e raketave do të shkrinte strukturat e akullit. Pas rënies së Murit të Berlinit, prania ushtarake amerikane u reduktua ndjeshëm, duke mbetur kryesisht në Thule. Sot, baza është nën administrimin e Space Force, forcës hapësinore të krijuar nga vetë Trump, e përfshirë në projektin ende teorik “Golden Dome” për mbrojtjen antiraketore nga hapësira.

Por një gjë mbetet e qartë: as historia dhe as realiteti strategjik nuk justifikojnë pretendimin se Groenlanda ka qenë ndonjëherë territor amerikan. Ajo ka qenë dhe mbetet pjesë e Mbretërisë së Danimarkës, pavarësisht interesave dhe pranisë ushtarake të fuqive të mëdha./La Repubblica



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

FFK-ja ndan stemat e FIFA-s për gjyqtarët dhe asistentët

PRISHTINË, 22 JANAR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka bërë ndarjen e stemave të FIFA-s për gjyqtarët dhe asistentët për vitin 2026. Ndarjen e stemave e ka bërë presidenti i FFK-së, Agim Ademi dhe kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve të

Futbollit të Kosovës, Përparim Hasani. Me këtë rast, presidenti Ademi ka çmuar angazhimin dhe përkushtimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve, duke nënvizuar rolin e tyre thelbësor në zhvillimin dhe suksesin e futbollit në Kosovë

si në garat vendore ashtu edhe në ato ndërkombëtare. I pari i FFK-së ka inkurajuar gjyqtarët ta vazhdojnë punën me përkushtim maksimal dhe vigjilencë të shtuar, me synimin për t'i arritur standardet më të larta të profesionalizmit.



SYLVINHO BESON SE SHQIPËRIA MUND TË KUALIFIKOHET NË KUPËN E BOTËS

TIRANË, 22 JANAR - Përzgjedhësi i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho, beson se kuqezinjtë kanë potencialin për ta realizuar ëndrrën e madhe të kualifikimit në Kupën e Botës, që këtë vit do të mbahet në ShBA, Meksikë dhe Kanada. Në një intervistë për Federatën Shqiptare të Futbollit, tekniku brazilian ka dhënë një përgjigje të shkurtër, por domethënëse, lidhur me këtë objektiv madhor. "Patjetër", ishte përgjigja e shkurtër e Sylvinhos në fund të intervistës dhënë për Federatën Shqiptare të Futbollit. Sylvinho ka folur në fillim të intervistës për ndeshjet e Shqipërisë gjatë vitit të kaluar. Ai është i kënaqur me arritjet dhe rezultatet e ekipit kuqez.

"Pas një momenti shumë të vështirë në Letoni, më pas në shtator kemi mundur Letoninë, në tetor kemi mundur Serbinë në transfertë dhe në nëntor Andorrën po në udhëtim. Ai ka qenë momenti kur kam parë një skuadër më të matur, pas tre vjetësh që kam parë kualifikueset e Evropianit dhe një Evropian të rëndësishëm dhe të bukur. Mund të them që tashmë jemi mësuar të luajmë ndeshje të rëndësishme, vendimtare, qoftë ndaj Italisë apo ndaj një skuadre pak më modeste. Këta lojtarë kanë filluar të kuptojnë dhe të luajnë ndeshje me kombëtare të rëndësishme, vendimtare. Ata kanë bërë shumë mirë, në të tria ndeshjet radhazi, nuk ka qenë e lehtë, kemi fituar dhe kjo na ka sjellë në play-off. Sipas

meje, ata tre muaj kanë qenë shumë të bukur", ka thënë braziliani. Ai ka komentuar edhe për Poloninë, kundërshtaren e play-off-it për kualifikim në Botëror. Ndeshja Poloni - Shqipëri luhet në Varshavë më 26 mars. Finalja e play-off-it është më 31 mars. "Flasim për dy ndeshje, të gjithë vijnë aty në 100 % e tyre. Herë pas here dëgjoj këtu që mund të ketë një skuadër e dobët apo të lehtë për t'u mundur. Unë si trajner që e jetoj futbollin prej një dekade, nuk jam dakord. Futboli ka ndryshuar, shikohet çdo gjë, në 90 minuta mund të ndodhë çdo gjë. Polonia është një skuadër e fortë, e njohim mirë. Polakët kanë një proces, ne kemi një tjetër, tani do të luhet, mund të ndodhë gjithçka", ka shtuar



Sylvinho. Polonia nuk është kundërshtare e panjohur për Shqipërinë. Sylvinho ka bërë krahasimin e përballjeve të mëhershme me polakët. "Për futbollin, tre muaj pas ndryshon çdo gjë, tani po flasim për 2-3 vjet më parë. Polakët kanë një skuadër shumë të mirë, lojtarë të mëdhenj. Pak njerëz e dinë ose e kujtojnë që e njëjta Poloni katër vjet më parë shkonte në play-off për Botërorin e vitit 2022. Ndeshjen e parë nuk e ka luajtur, sepse ishte ndaj

Rusisë, por në ndeshjen e dytë ka mundur Suedinë me rezultatin 2:0. Është një skuadër me lojtarë të rëndësishëm, janë të mësuar dhe e njohin mirë fazën play-off, kanë marrë pjesë edhe në Botëror. Nga ana jonë, kemi një skuadër që është përmirësuar shumë, është një skuadër që tashmë është mësuar të luajë ndeshje të vështira, vendimtare, përveç vështirësisë, se të gjitha janë të tilla, por ndeshje vendimtare. Janë 90 minuta, ku e di që duhet të gabosh sa më pak dhe që çdo gjë është e rëndësishme, pasi gabimi më minimal mund të të bëjë shumë dëm. Unë besoj shumë në skuadrën tonë, në lojtarët dhe punën tonë. Mungojnë ende 2-3 muaj. Uroj të shkojmë atje me forcën tonë maksimale", ka thënë Sylvinho.

REAL MADRIDI KRYESON BOTËN E FUTBOLLIT PËR NGA FITIMET NË SEZONIN 2024/25

MADRID, 22 JANAR - Real Madridi ka thyer çdo rekord financiar duke udhëhequr renditjen globale të klubeve më fitimprurëse për sezonin 2024/25, ndërsa Barcelona, Bayern Munich, Paris Saint-Germain dhe gjigantët e Ligës Premierë kanë konfirmuar fuqinë ekonomike të elitës evropiane. "Deloitte Money League" ka treguar qartë se dominimi në futboll sot matet po aq me të ardhura sa edhe me trofe. Klubi mbretëror ka konfirmuar dominimin e tij jo vetëm në

fushë, por edhe financiarisht. Sipas renditjes së "Deloitte Football Money League 2026", Real Madridi ka gjenë plot 1.16 miliard euro, duke u bërë klubi i parë në histori që kalon pragun e një miliardi në një sezon. Në vendin e dytë renditet Barcelona me 942 milionë euro, një rikthim i fortë financiar pas viteve të vështira. Të ardhurat nga marketingu, stadiumi dhe rikthimi në elitën evropiane kanë luajtur rol kyç në rritjen e blaugranëve.



Bayern Munichu mban pozitën e tretë me 831 milionë euro, duke konfirmuar stabilitetin financiar dhe modelin e qëndrueshëm të menaxhimit. Pas gjigantit gjerman vjen Paris Saint-Germain me 808 milionë euro, ku ndikimi i

marketingut global dhe yjeve vazhdon të jetë vendimtar. Liga Premierë dominohet nga disa klube në top 10. Liverpooli është i pesti me 807 milionë euro, i ndjekur ngushtë nga Manchester City me 802 milionë dhe Arsenali me 794 milionë euro, duke dëshmuar fuqinë ekonomike të kampionatit anglez. Manchester Unitedi renditet i teti me 766 milionë euro pavarësisht prej rezultateve të paqëndrueshme sportive. Pas tyre vjen Tottenham Hotspuri me 650 milionë euro dhe Chelsea me 566

milionë euro, që mbeten marka të forta në tregun global. Top 15 plotësohet nga Interi me 538 milionë euro, Borussia Dortmund me 531 milionë euro, Atletico Madridi me 454 milionë euro, Aston Villa me 435 milionë euro dhe AC Milan me 410 milionë euro, klube që vazhdojnë të ruajnë peshë të madhe ekonomike në futbollin evropian. Raporti e bën të qartë se elita e futbollit modern nuk ndërtohet vetëm me rezultate sportive, por edhe me menaxhim financiar të fuqishëm dhe strategji afatgjatë.

Tabaku dhe Fazliu zgjedhen më të mirët e vitit nga Federata e Sporteve Universitare të Kosovës

PRISHTINË, 22 JANAR - Federata e Sporteve Universitare e Kosovës, në praninë e personaliteteve të rëndësishme të sportit, asimit të lartë, si dhe partnerëve të saj, ka organizuar ceremoninë

solemne "Laureatët 2025", ku janë ndarë çmimet për sportistët, trajnerët dhe të gjithë ata që janë dalluar për sukseset dhe përkushtimin e tyre gjatë një viti të jashtëzakonshëm për sportin universitar.

Gjatë ceremonisë janë ndarë çmimet kryesore të vitit, si sportisti i vitit dhe trajneri i vitit 2025. Këto dy çmime kanë shkuar për xhudon ku "Sportistja e Vitit 2025" është shpallur Laura Fazliu, për suksesin e jashtëzakonshëm

në FISU World University Games, Rhine-Ruhr 2025. Ndërsa çmimi "Trajneri i Vitit" i është dhënë Fatos Tabakut për kontributin profesional dhe angazhimin e tij në FISU World University Games, Rhine-Ruhr 2025.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Metal Construzion” Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për fabrikën për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e nikelit, bakrit dhe metalet ferore në Janjevë, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.03.2026 në ora 14:00 në SHFMU “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë, do të organizohet debat publik nga “Metal Construzion” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:
<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Metal Construzion” Sh.p.k. Prishtinë - për fabrikën për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e nikelit, bakrit dhe metalet ferore në Janjevë, Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>
Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin
vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “EMC Company” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812097617 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “EMC Company” L.L.C. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812097617 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “EMC Company” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812097617 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Sharri” Sh.p.k., Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për fabrikën për përpunimin e qumshtit në Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.03.2026 ora 10:00 në Shkollën e mesme e lartë Profesionale “Ymer Prizreni”, në Prizren do të organizohet debat publik nga “Sharri” Sh.p.k., Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:
<https://us05web.zoom.us/j/2693380475?pwd=ZEpzTUNmaHITRVN3VXZqRU5kaXRTUT09>

Meeting ID: 269 338 0475
Passcode: BBqP2x

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Sharri” Sh.p.k., Prizren, për fabrikën për përpunimin e qumshtit në Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>
Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin
vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitim Gërbeshi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “Shtjefën Gjeçovi” Prishtinë.

- Ferdonije Shllaku shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Luan Alijaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Agim Leka shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Berat Kasapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.l. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI - Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin “Joos Krasniqi Limited Construction” Sh.p.k. Meje,Gjakovë, kërkesa për vazhdimin e Lejes Mjedisore me Nr.Prot.25/4565/MMPHI/331/DMM, për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, Shkoza, Komuna e Junikut, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 20.02.2022, në ora: 10:00, në hapësirat Administrative të Kompanisë “Joos Krasniqi Limited Construction” Sh.p.k. Komuna Junik do të organizohet debati publik nga operatori “Joos Krasniqi Limited Construction” Sh.p.k. Meje, Gjakovë, kërkesa për vazhdimin e Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/4565/MMPHI/331/DMM, për veprimtarinë: Eksploitim i gurit gëlqeror, Shkoza, Komuna e Junikut, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us05web.zoom.us/j/85445988818?pwd=GDNBuWpXSHoxSkiX3kiYkOb8qwBAWF.1>

ID: 854 4598 8818
 Passcode: 6GF68z

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=joo>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

"Joos Krasniqi Limited Construction" Sh.p.k.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI - Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin “Italy Recycling” L.L.C. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/5892/MMPHI/468/DMM për veprimtarinë: Qendër e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, Obiliq, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 19.02.2026, në ora: 09:30, në hapësirat Administrative të Kompanisë “Italy Recycling” Sh.p.k. Obiliq, do të organizohet debat publik nga operatori “Italy Recycling” L.L.C. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/5892/MMPHI/468/DMM për veprimtarinë: Qendër e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us05web.zoom.us/j/84145160517?pwd=TjFwYN40xOTubKdY9YKrkOHV0nmvCb.1>

ID: 841 4516 0517
 Passcode: 12345678

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=italy>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"Italy Recycling" L.L.C




Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

“Palma” SH.P.K.
me numër Unik
Identifikues:
810679417, Gjilan
me pronar Ekrem
Shahini bënë shpallje
në gazetë për
zvogëlim të kapitalit
nga 1759953.92 Euro
në 4000 Euro.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L